


Indeksi i Çmimeve të Importit

Tremujori III, 2025

Tiranë, më 05 Dhjetor: Indeksi i Çmimeve të Importit, në tremujorin e tretë të vitit 2025, arriti 107,4 kundrejt vitit 2021 si periudhë bazë. Krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit 2024, indeksi i çmimeve të importit shënoi një ulje me 0,5 %, ndërkohë që një vit më parë ky ndryshim ishte -1,3 %. Në krahasim me tremujorin e dytë të vitit 2025, indeksi i çmimeve të importit shënoi një ulje prej 0,2 %.

Fig.1: Ndryshimet vjetore të Indeksit të Çmimeve të Importit sipas tremujorëve



Ndryshimi vjetor: Krahasuar me tremujorin e tretë 2024, çmimet e importit të produkteve në seksionin “Energjia elektrike, gazi, avulli dhe ajri kondicionuar” shënuan ulje me 4,6 %, pasuar nga seksionet “Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve” me 0,7 %, “Industria përpunuese” me peshën më të madhe prej 94,0 %, me 0,3 %. Nga ana tjetër seksioni “Industri nxjerrëse” shënoi një rritje me 0,4 %. Brenda seksionit “Industria përpunuese” ulja më e madhe e çmimeve vërehet në produktet e aktiviteteve “Përpunimi i produkteve ushqimore” me 1,7 % pasuar nga “Prodhimi i drurit dhe produkteve prej druri dhe dushku, përveç mobiljeve; prodhimin e artikujve prej kashte dhe xunkthi” me 1,2 %, “Konfeksionimi i veshjeve” me 0,8 % , “Prodhimi i pijeve” me 0,6 % dhe “Prodhimi i kimikateve dhe produkteve kimike” me 0,5 %. Nga ana tjetër, çmimet në aktivitetin “Industri të tjera p.k.t” shënuan rritje me 1,3 %, pasuar nga “Prodhimi i produkteve të duhanit” me 1,1 % dhe “Shtypshkrimi dhe rigrupimi i mediave të regjistruara” me 0,8 %, etj.

Ndryshimi Tremujor: Krahasuar me tremujorin e dytë 2025, çmimet në seksionin “Energjia elektrike, gaz, avull dhe ajër i kondicionuar” shënuan ulje me 1,1 %, pasuar nga “Industria përpunuese” me 0,1 %. Nga ana tjetër “Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve” shënoi një rritje me 0,9 %. Brenda seksionit “Industria përpunuese”, ulja më e madhe e çmimeve vërehet në produktet e aktivitetit “Përpunimi i produkteve ushqimore” me 1,3 %, pasuar nga “Prodhimi i kimikateve dhe produkteve kimike” me 0,9 % dhe “Përpunimi i tekstileve” me 0,6 %. Nga ana tjetër, çmimet e aktivitetit “Prodhimi i produkteve metalikë të fabrikuar, përveç makinerive dhe pajisjeve” shënuan rritje me 0,8 %, pasuar nga “Prodhimi i produkteve të duhanit” me 0,7 %, etj.

Për më shumë informacion dhe për të parë tabelat e detajuara, vizitoni bazën e të dhënave në faqen zyrtare të INSTAT: [Indeksi tremujor i Çmimeve të Importit](#)

Metodologjia

Indeksi i Çmimeve të Importit mat ecurinë e çmimeve të transaksioneve të produkteve industriale të importuara për tu shitur në tregun vendas,

INSTAT llogarit dhe publikon:

Indeksin e Çmimeve të Importit

Ndryshimet tremujore dhe vjetore të indeksit

Fusha e mbulimit:

Seksioni B - Industri Nxjerrëse

Seksioni C – Industri Përpunuese

Seksioni D - Furnizimi me Energji Elektrike, Gaz e Avull dhe me Ajër të Kondicionuar

Seksioni E - Aktivitetet me ujë të ngrohtë, kanalizimeve, menaxhimit të mbeturinave dhe rregullimit

Llogaritja e indeksit

Indekset llogariten për çdo produkt të klasifikuar sipas Nomenklaturës së Produkteve (NP 2008) në nivel 6-shifror dhe publikohen sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike (NVE rev.2) në nivel 2-shifror. Duke filluar nga tremujori i parë 2024 e në vazhdim Indeksi i Çmimeve të Importit ka si periudhë referuese vitin 2021 = 100. Metoda e llogaritjes së indeksit është metoda zinxhir (Laspeyres - chain index) sipas së cilës, çmimi i produktit në periudhën korente (y) krahasohet me çmimin e muajit Dhjetor të vitit të mëparshëm (y – 1).

Për llogaritjen e indeksit përdoret formula si më poshtë:

$$I_{korrent}^{y,m} = \frac{100}{\prod_{Y=2021}^{y-1} \sum^{Dec} I_{Y-1,Dec}^{Y,M}} + \prod_{Y=viti\ baz\ e}^{y-1} I_{Y-1,Dec}^{Y,M} * I_{y-1,Dec}^{y,m}$$

- Pjesa e parë e formulës tregon ndryshimin e çmimeve të muajit Dhjetor të vitit të mëparshëm krahasuar me mesataren e çmimeve në vitin bazë.

- Pjesa e dytë e formulës tregon lëvizjen zinxhir të indeksit të çmimeve nga muaji Dhjetor të vitit të mëparshëm deri në periudhën y-1.

- Pjesa e tretë e formulës tregon ndryshimin e çmimeve nga muaji Dhjetor y-1 në muajin m të vitit y.

Matësit e Indeksit

Ndryshimi vjetor mat ndryshimin e çmimit midis tremujorit korrent dhe të njëjtit tremujor të vitit të kaluar. Ky ndryshim është rrjedhojë e ndryshimeve vjetore në nivelet e çmimeve, por mund të ndikohet edhe nga efektet e papërsëritshme të çdo tremujori.

Ndryshimi tremujor mat ndryshimin e çmimit midis tremujorit korrent dhe tremujorit të mëparshëm.